




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.
2-D/DPK	01-268/16
Nr. i Titullit / Broj. titulla / Nr. pages	Data / Datum / Date
02	26.01.2016
PRINTIME	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.01.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4236/15, për z. Nexhat Bytyqi – Anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4236/15, për z. Nexhat Bytyqi – Anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit, dhe njëkohësisht pronar në bizneset private “ALBING-B” SH.P.K., HIM-GROUP” SH.P.K dhe “SABITALITY” SH.P.K., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit pas së cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e AKK-së.

z. Bytyqi është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksione menaxheriale në biznese private, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë, ndërsa ai ka deklaruar se do të shmang konfliktin e interesit duke u larguar nga funksioni publik.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci formularin e plotësuar, “Deklarim pas largimit nga funksioni”, me të cilin dëshmohet se z. Bytyqi tashmë nuk e ushtron funksionin e Këshilltarit Komunal e as

ndonjë funksion tjetër publik. Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

